



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 149/1 Prot.

Tiranë, më 24.01.2023

V E N D I M

Nr. 13, Datë 24.01.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 169, datë 09.11.2022, e N.H kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier (DRSSH Fier), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “moshës¹” dhe “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam N.H dhe referuar Vërtetimit nr. 220/1, datë 08.03.2007 të Ministrisë së Brendshme, vërtetohet se kam qenë i dëbuar për arsye politike nga rrethi Skrapar në rrethin Fier prej vitit 1955 deri në datën 30.09.1991. Pas daljes në pension në vitin 2020, nuk më është llogaritur trajtimi si ish i përndjekur politik. Për shkak të moshës dhe mungesës së informacionit, nuk e kam ankimuar faktin që nuk kam qenë dakord me masën e pensionit. Ankuesi informon se ka persona të tjerë të cilët trajtohen me statusin e ish të përndjekurit politik dhe përfitojnë pension për këtë arsye, si psh: G.M; Q.G; R.K dhe Q.H”.

¹ Ankuesi ka lindur në datë 30.08.1955 dhe është pensionist, librezë nr. 154059.

² Referuar Vërtetimit nr. 604, datë 15.03.2007, të lëshuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë, vërtetohet se N.H i jepet e drejta e Statusit të ish-të Përndjekurit Politik.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rivlerësimin e masës së pensionit duke përfituar shpërblimin si i dëbuar politik.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”*.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 169, datë 09.11.2022, të paraqitur nga N.H, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1457/1, datë 17.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga DRSSH Fier, për ankesën e bërë nga N.H si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Kopje të dosjes së pensionit të subjektit ankues.
 - Shpjegime nëse ka patur raste të njëjta apo të ngjashme të llogaritjes së pensionit si ish i përndjekur politik për shtetas të tjerë dhe kopje të dokumenteve të dosjeve të: (G.M, Q.G, R.K dhe Q.H).

Me shkresën nr. 14558/1, datë 25.11.2022, DRSSH Fier, informoi Komisionerin se: *“N.H, është i datëlindjes 30.08.1955. Me Vendimin nr. 5174, datë 13.01.2021 DRSSH Fier i ka caktuar pension pleqërie, periudha e sigurimit 28 vite e 4 muaj, baza mesatare e vlerësuar mbi të cilën llogaritet pensioni ka rezultuar 33.913 lekë, pensioni në masën fillestare 16.161 lekë, me të drejtë pagese prej datës 30.08.2020.*

Periudhat e sigurimit të llogaritura në pension janë si më poshtë:

- 30.08.1970 - 30.09.1991; Llogaritur me pagën referuese si i persekutuar politik 3.494 lekë.
- 01.10.1991 - 15.11.1992; Ndërmarrja Bujqësore punëtor, llogaritur me pagën referuese të bujqësisë; kodi c20 = 2.833 lekë.
- 01.01.1993 – 04.12.1993; Drejtoria e Policisë Fier, llogaritur me pagën referuese; kodi a25 = 2.740 lekë.
- 01.10.1994 - 30.09.1995; Repart ushtarak, llogaritur me pagën mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore.
- 01.02.1996 - 30.04.2000; Repart ushtarak, llogaritur me pagën mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore.

Gjatë periudhës 30.08.1970 - 30.09.1991, N.H ka punuar në kooperativë në vitet 1971-1973 dhe 1976-1986; ka kryer shërbimin ushtarak në periudhën 1973-1976; dhe ka punuar në ndërmarrje bujqësore në vitet 1986-1992. Me vërtetimin nr. 220/1, datë 08.03.2007 të Ministrisë së Brendshme është vërtetuar se N.H është dëbuar për arsye politike nga rrethi Skrapar në rrethin Fier, prej vitit 1955 deri në datën 30.09.1991.

Bazuar në pikën 10, të Udhëzimit nr. 2, datë 04.01.1992 të Këshillit të Ministrave, për zbatimin e ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve

dhe të përndjekurve politikë”, koha e internimit dhe dëbimit për motive politike nuk njihet vjetërsi pune para moshës 15 vjeç.

Duke u bazuar në vërtetimin sipërcituar për njohjen e kohës së vuajtjes së dënimit administrativ, për arsye politike, për llogaritjen e pensionit për vlerësim të periudhës 30.08.1970 (mbushja e moshës) deri në 30.09.1991, jemi bazuar në VKM nr. 77/2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore” në të cilën është parashikuar: “Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë të jetë e barabartë me 4.302 (katërmijë e treqind e dy) lekë e indeksuar me koeficientin përkatës sipas viteve. Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me internim, kur internimi është dhënë si dënim penal plotësues dhe dëbimit për kohën e vuajtjes së dënimit për të dëbuarit të jetë e barabartë me 3.494 (tremijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj, e indeksuar me koeficientin përkatës të viteve, etj”.

Referuar datëlindjes së N.H dhe nenit 92, periudha e sigurimit e kërkuar në momentin e lindjes të së drejtës për pension pleqërie është 37 vite, ndërsa periudha e punës e realizuar nga ana e tij është 28 vite e 4 muaj. Bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, “Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave për të cilat janë paguar kontributet me periudhën që njihet si periudhë sigurimi”.

Referuar dispozitave si më sipër, DRSSH Fier, që në momentin e caktimit të pensionit të pleqërisë për N.H ka marrë parasysh për efekt llogaritje, vërtetimin e lëshuar nga Ministria përkatëse për njohjen e kohës së dëbimit politik, duke e vlerësuar me pagën 3.494 lekë, periudhën 30.08.1970-30.09.1991.

Bazuar në VKM nr. 605, datë 14.9.2022, “Për indeksimin e pensioneve”, masa e pensionit për N.H, pasi ka marrë rritjet sipas VKM-ve, është në masën 18.174 lekë në muaj.

Sa i përket përfitimeve të qytetarëve, me të dhënat e përmendura në shkresë, nuk na rezultojnë përfitues në rajonin Fier dhe e kemi të pamundur dërgimin e kopjeve të dosjeve”.

Me shkresën nr. 7782/2, datë 13.12.2022, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, informoi Komisionerin se: “DRSSH Fier, në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me Vendimin nr. 5174, datë 13.01.2021, i ka caktuar N.H, pension pleqërie, si i dëbuar për arsye politike, me 28 vite e 4 muaj periudhë sigurimi, në masën 16.161 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 30.08.2020.

Në llogaritjen e periudhave të sigurimit, për efekt të llogaritjes së përfitimit, janë përfshirë të gjitha periudhat e sigurimit të deklaruar nga ana e tij dhe të konfirmuara me dokumentacion zyrtar.

Pagat referuese për periudhën 30.08.1970 - 30.09.1991, gjatë së cilës i interesuari ka qenë i dëbuar për arsye politike, janë përzgjedhur në masën 3.494 lekë, sipas përcaktimeve të VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar; pagat referuese për periudhën 01.10.1991-31.12.1993, janë përzgjedhur sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 561, datë 12.08.2005 “Për caktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të ndryshuar dhe për periudhën pas 01.01.1994, janë llogaritur pagat, mbi të cilat janë paguar kontributet.

Referuar datëlindjes së N.H dhe nenit 92, të Ligjit nr. 7703/1993, i ndryshuar, periudha e sigurimit e kërkuar në momentin e lindjes së të drejtës për pension pleqërie është 37 vite, ndërsa periudha e punës e realizuar nga ana e të interesuarit, është 28 vite e 4 muaj.

DRSSH Fier, ju ka informuar zyrtarisht, me shkresën nr. 14558/1, datë 25.11.2022, mbi masën e pensionin të pleqërisë, të N.H, si ish i dëbuar për arsye politike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

ISSH, për personat të cilët plotësojnë kriteret për pension, sipas parashikimeve të ligjeve në fushën e sigurimeve shoqërore dhe që kanë qenë të dënuar apo të internuar për motive politike, zbaton dispozitat e Ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, e udhëzimet në zbatim të tij dhe nuk ka një akt tjetër ligjor apo nënligjor, që ngarkon institucionin tonë, për akordimin e pensioneve të veçanta të kësaj kategorie”.

Në përgjigje të shkresave të dërguara nga DRSSH Fier dhe ISSH, subjekti ankues me e-mail-in datë 15.12.2022, ka informuar se nuk është dakord dhe nuk është i qartë për mënyrën e llogaritjes së pensionit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

I. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses.

Mbështetur në nenin 31, pika 1, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji.

Referuar nenit 32 të këtij ligji përcaktohet se:

- 1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.*
- 2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social.*

3. *Shtesa do të jetë 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, e llogaritur sipas nenit 59, të këtij ligji.*
4. *Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.*

Në nenin 59 të këtij ligji, vlerësohet baza për llogaritjen e përfitimeve, kështu është përcaktuar si më poshtë:

1. *Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.*
Për periudhën e sigurimit nga data 01.01.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merret shuma e pagave për të cilat janë paguar kontributet nga data 01.01.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.
Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 01.01.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.
Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.
Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 01.01.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjës i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore, përpara vitit 1994, si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994.....

Në nenin 92 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet mosha dhe periudha e sigurimit që kërkohet për të përfituar pension pleqërie, në të cilin përcaktohet se burrat që dalin në pension në vitin 2020 (ankuesi), duhet të kenë 37 vite vjetërsi pune.

Në Kapitullin III, të Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, përcaktohen rregullat dhe procedurat për verifikimin e dokumenteve për pension, në të cilën përcaktohet se: “1. Verifikimi bëhet nga inspektorët verifikues pranë arkivës së DRSSH-së, ASHV-të ose në subjektet që janë duke kryer aktivitetet ekonomiko-financiar. 2. Objekt verifikimi janë dokumentet që vërtetojnë periudhën e sigurimit dhe pagën.....”.

Referuar në sa më sipër, DRSSH Fier, bazuar në legjislacionin e sipërcituar, me shkresën nr. 14-10-22430, datë 14.12.2020 kanë kërkuar nga Ministria e Brendshme vërtetim internim dëbimi për N.H.

Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar, Ministria e Brendshme me shkresën nr. 14-10-22430, datë 15.12.2020 ka informuar se: “.....Komisioni i krijuar për njohjen e kohës së vuajtjes së dënimit administrativ me Vendimin nr. 21, datë 10.03.1993, me shkresën nr. N-2437, ka vendosur njohjen e kohës së dëbimit nga Skrapari në Fier, prej vitit 1955 deri në datë 30.09.1991, për çështje politike, për shtetasin: N.H”.

Në pikën 10, të Udhëzimit nr. 2, datë 04.01.1992 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë””, përcaktohet se: “10. Koha e internimit dhe e dëbimit për motive politike nuk njihet vjetërsi pune para moshës 15 vjeç”.

Në Kreun VII, pika 8/2, të VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar, parashikohet se: “.....Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me internim, kur internimi është dhënë si dënim penal plotësues dhe dëbimit për kohën e vuajtjes së dënimit për të dëbuarit të jetë e barabartë me 3.494 (tremijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj, e indeksuar me koeficientin përkatës të viteve.....”.

Mbështetur në dokumentacionin e depozituar në cilësi prove rezulton se ankuesi N.H, i datëlindjes 30.08.1955, ka dalë në pension në vitin 2020. Me vendimin nr. 5174, datë 13.01.2021, të Drejtorit të DRSSH Fier, ankuesit i është caktuar pension pleqërie, për periudhën e sigurimit 28 vite e 4 muaj. Pensioni në masën fillestare është llogaritur në masën 16.161 lekë, me të drejtë pagese prej datës 30.08.2020.

Referuar dosjes nr. 154059 të ankuesit, rezulton se DRSSH Fier në fletën e llogaritjes për periudhën e sigurimit, ka llogaritur periudhën nga data 30.08.1970 deri në datë 01.10.1991, prej 21 vite e 1 muaj, si periudhë e vjetërsisë në punë për ankuesin.

Në këtë kontekst, bie pretendimi i ankuesit se nga ana e DRSSH Fier, nuk i janë llogaritur në masën e pensionit, vitet për periudhën që ka qenë i internuar për çështje politike.

Në nenin 86 “Ankimimi”, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Ankimi në këto raste, depozitohet pranë sporteleve të shërbimit, në përputhje me legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel;
2. Ankimi kundër vendimeve të Komisionit të Ankimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore bëhet në Komisionin e Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i të cilës është përfundimtar.....”.

Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti ankues, nuk e ka ankimuar vendimin e DRSSH Fier në asnjë nga komisionet, sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e DRSSH Fier.

Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ekziston diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të N.H, për shkak të moshës dhe statusit si ish i përndjekur politik, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA